



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.1300/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me numër biznesit 70280741, seli në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës – DSHPI, me seli në Mitrovicë, rr. “Bedri Gjinaj”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson e përfaqëson L.Z., avokat me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm – faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2638/22, të datës 28.07.2023, me datën 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës Sh.A., me numër biznesit 70280741, seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2638/22, të datës 28.07.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2638/22, të datës 28.07.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Mitrovicës - DSHPI, ndërsa Urdhri Përmbare P.nr. 403/22, i lejuar me datë 02.12.2022, nga Përmbaresi Privat Ilmi Miftaraj e ka anuluar.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit, të prishet aktvendimi KPPP.nr.2638/22 të dt.28.07.2023 ashtu që të mbetet në fuqi urdhri përmbare P.nr.403/22 i datës 01.12.2022, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit – Faturës nr. 191031092663/2212, për periudhën kohore 01.09.2021, e deri më 30.09.2021, ka lejuar Urdhri Përmbartimor P.nr.403/22, të datës 02.12.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga fatura, brenda afatit 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumë prej 818.35€, me kamatëvonesë prej 8% duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme, përkatësisht data sipas faturës, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura nuk është e përshtatshme për përmbartim. Ka shtuar se fatura në fjalë nuk është pranuar në mënyrë të rregullt dhe si e tillë nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Më tej, ka theksuar se e njëjta faturë nuk është as e pranuar dhe as e nënshkruar nga personat kompetent pranë debitorit, dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet për të qenë e përshtatshme për përmbartim në kuptim të nenit 27 të LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se i njëjti nuk i plotëson kushtet në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. Ka shtuar se janë të pabazuara pretendimet e debitorit se i njëjti nuk është njoftuar me faturat për pagesë, ngase debitori në baza mujore ka pranuar çdo muaj faturat përmes email, e po ashtu kreditori në vazhdimësi ka komunikuar me zyrtarët përgjegjës të debitorit duke i njoftuar këta të fundit për detyrimet e papaguara. Më tej, ka theksuar se të gjitha shërbimet janë shfrytëzuar nga ana e debitorit deri me datë 31.12.2021, rrjedhimisht debitori ka shfrytëzuar shërbimet e Vala, konform kërkesës së tij, ndërsa mos protokollimi i fatura siç pretendon debitori është çështje e tij e brendshme dhe se kjo çështje procedurale e brendshme nuk e largo nga përgjegjësia për shlyerjen e obligimeve ndaj kreditorit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2638/22, të datës 28.07.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Mitrovicës - DSHPI, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr. 403/22, i lejuar me datë 02.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj e ka anuluar, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit. Ne arsyetim ka theksuar se duke u bazuar në atë se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në faturë nuk janë përshkruar shërbimet e ofruara debitorit dhe në të njëjtën nuk është përcaktuar saktë shuma e cila është detyrim për periudhën kohore për të cilën është lëshuar fatura, prej datës 01.09.2021 deri

më 30.09.2021, për arsye se në faturë është përcaktuar borxhi paraprak i mbetur në lartësi prej EUR 818.35, mirëpo nuk është treguar se si ka rrjedhur ky borxh i debitorit, për cilat shërbime apo për cilën periudhë kohore, ndërsa në anën tjetër, borxhi për faturën dhe përudhen kohore të përcaktuar si në propozim për përmbarrim nga kreditori, rezulton të jetë zero Euro. Andaj , mbi këtë bazë e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin për përmbarrim. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përmbarrues ka caktuar përmbarrimin, nuk i plotëson tiparet e përmbarrueshëmërisë.

Me Nenin 29 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP) është përcaktuar se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton se *“faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla”* . Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Prandaj, në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarrimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në faturë me nr. 191031092663/2212, për periudhën kohore 01.09.2021, e deri më 30.09.2021 nuk janë përshkruar shërbimet e ofruara debitorit dhe në të njëjtën nuk është përcaktuar saktë shuma e cila është detyrim për periudhën kohore për të cilën është lëshuar fatura, prej datës 01.09.2021 deri më 30.09.2021, për arsye se në faturë është përcaktuar borxhi paraprak i mbetur në lartësi prej 818.35€, mirëpo nuk është treguar se si ka rrjedhur ky borxh i debitorit, për cilat shërbime apo për cilën periudhë kohore, ndërsa në anën tjetër, borxhi për faturën dhe përudhen kohore të përcaktuar si në propozim për përmbarrim nga kreditori, rezulton të jetë zero Euro. Po ashtu, fatura nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit dhe e njëjta nuk rezulton të jetë pranuar nga debitori. Ndërsa, në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën dëshmohet se kjo faturë i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë të rregullt, dhe si e tillë, fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri paraqet dokument të njëanshëm.

Prandaj, Kjo Gjykate vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, dhe mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, për këtë arsye Gjykata e shkallës së Parë drejt ka vepruar kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor P.nr.403/22 dt.02.12.2022 e ka anuluar.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarim është lejuar mbi bazën e faturës të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por fatura nuk përmban as elementet për t'u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase mungon pranimi i rregullt.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1300/23, me datë 08.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova